



AMMINISTRAZIONE COMUNALE
FONDAZIONE "G. DE RADA"
SPORTELLO LINGUISTICO COMUNALE
S. COSMO ALBANESE / STRIGARI

**POETI POPOLARI
DI SAN COSMO ALBANESE**

2006

ARCANGELO BUA



VJERSHE MBË DASHURI

1. Pse ti, kur shkonj u, e shehur rri?
Pa dil te praku deres ndonj her.
U doj të t' ruanja vetem ata si
e pra të humbsha ndutu ka ki dhe.
2. Shkonj e prir e shkonj ka kjo udh
se të t'shoh tij, vashes hadhjare.
Donja t'e dinja ndë më vure re,
kështu skultarça e prënja këta tru.
3. Ndë dinje se sa her të gjegja fjalen
donja të kisha ardhur t'e përgjegjja.
Nani të shkruenj e të dërgonj të fala:
te zëmëra m'u stise ti, kopile.
4. Ti, vash hadhjare çë u t'ëndërrinj naten,
ndë mest aq trimëri ti rri e vetem.
Më mbajte besen e shum mir të dua
se zëmra jote rron vetem për mua.
5. O vash ç' te dritësora rrihamar,
të qeshen picjeti nd'ata duer.
Pusho nj' cik, gjegj e ndreghullar
se çë të thot ki mall e mirre mir.

STORNELLI D'AMORE

1. Perché, quando passo, te ne stai nascosta? / Esci qualche volta alla soglia della porta. / Mi basterebbe vedere quei tuoi occhi / e poi sparissi pure dalla terra. / 2. Passo e ripasso per questa strada / per vederti, ragazza graziosa. / Vorrei sapere se mi hai notato, / così mi metterei l'anima in pace. / 3. Se sapessi quante volte ho ascoltato la tua parola, / vorrei esser venuto a farle eco. / Ora ti scrivo per mandarti i saluti. / Nel mio cuore, ragazza, ti sei infissa. / 4. Ragazza graziosa che mi visiti in sogno, / tra tanta gioventù te ne stai sola. / Mi sei stata fedele e ti amo / perché solo per me vive il tuo cuore. / 5. Ragazza che ricami alla finestra, / nelle mani ti ride l'uncinetto. / Smetti per un poco, senti ed intendi bene / ciò che dice chi t'ama e comprendilo. /

6. Ti je mb'at an e u të jam kundrela,
kjo bukuria jote zëmren më ngjall.
Kam qasem afer se të t' gjegjinj fjalën,
si kur ti je Parrajsi e u jam nj'ëngjell.
- 7 Sa u di sot më qeshi dita,
ngë di cili shënjt më parkalesi.
Ndë qeve ti çë m'mban mbë krie,
me tij ndërron edhe gjella për mua.
8. Pa ru' si moti shkon e si shkon jeta
e për të ziun njeri gjella u shkurtua.
U rrova si i harrur ka fati.
Të bora vash, nani të çova grua.
9. Të rrita ndë një ghrast si një lule,
më thonje sembre se u rronj për tia.
Nani u moçme e ng' je më kopile.
Si një linar u shuete edhe për mua.
10. U leva djal, u rrita e u bëra trim
e për shurbemjen eca dhen shumë mot.
Nani u mbjodha e do t' gdhohirnja nj' dit.
Tia, vash, së t' çova e qëndrova i shkret.
11. E vajte tue thën se u jam poet
çë vete tue kënduer dit e nat.
U jam një njeri si më i shkret:
donja t' gdhohirnja dhen, ma jam pa fat.

6. Tu stai dall'altra parte ed io di fronte, / la tua bellezza mi rinfranca il cuore. / A te mi accosto per sentirti parlare: / tu sei il Paradiso ed io un angelo. / 7. Al primo albore mi sorrise il giorno, / non so quale santo ha pregato per me. / Se sei stata tu che mi tieni nei tuoi pensieri / con te cambia anche la mia vita. / 8. Ve' come passa il tempo e l'esistenza / e per il misero uomo s'è accorciata la vita. / Io ho vissuto quasi dimenticato dal destino. / Ti ho persa che eri fanciulla, ti ritrovo donna. / 9. Ti ho cresciuta in un vaso come un fiore, / sempre mi dicevi: "Vivo per te!". / Sono passati gli anni e non sei più fanciulla. / Come lucerna ti sei spenta anche per me. / 10. Sono nato bambino, cresciuto e diventato giovane / e, per lavorare, a lungo ho percorso il mondo. / Al mio ritorno, volevo godere almeno un giorno, / ma non ti ho ritrovata e sono restato infelice. / 11. Hai detto in giro che sono un poeta / che notte e giorno se ne va cantando. / E invece sono solo un infelice: / vorrei godere il mondo, ma sono sfortunato. /

12. Vajta si rreshinjolli tue këndur,
vullarta çuk për çuk pa u lodhur fare.
Nani u mbjaka e jam pjot dhullur
s'kur te ki dhe s'u kisha ler fare.
13. Ka dejti dielli del e rrëmbe shtie,
ngrohen sheshe e male edhe ghora.
Ngrëhen zogjt e fjeturonjen tek era.
Vet' mua së m' ngrohen më çë kur të bora.
14. Frin vorea, moti u vu mbë bor,
zogjët fundakosen ndër fole.
Vet u si i shkret mose mb'udhet rri
tue kultuer tia, vash çë ngë je më.
15. O nat, o nat pa hën, sa e gjata je.
U vete tue ngar ndë errësi,
se u leva edhe pa fat u te ki dhe,
ndë jam i gjall o i vdekur nëng e di.

Estate 2005

12. Come usignolo me ne andai cantando / e, mai stanco, volai di cima in cima. / Ora son vecchio e pieno di dolori, / sempre lontano dalle gioie del mondo. / 13. Dal mare è spuntato il sole e manda i suoi raggi / scaldando pianure, monti e città. / Si levano gli uccelli e volano al vento. / Solo me non riscalda, da quando ti ho perduta. / 14. Soffia la tramontana, il tempo minaccia neve, / s'acquattano gli uccelli nei nidi. / Solo io infelice me ne sto per strada, / ricordando te, ragazza, che più non sei. / 15. Quanto sei lunga, notte, notte illune. / Al buio cammino, / nato per l'infelicità, / né so se vivo ancora o sono morto.

SHQËNDA

Shkova ka gardhi e pe nje shqënd.
Sa u qasa ndieta nj'ardur,
një skamandil i art që m'u shutar
e thaç: "Ki ë fati im që më do mir!".

U nisa e vajta e eca der për der
se të t' çonja tia, vashes hadhjare.
Të solla shqëndën që kishe harrur,
ki është arduri it që më pëlqeu.

Nani që xura vendin ku ti je
u vinj e të këndonj një vjesh të ri.
Të siell një mac lule e, ndë m' ka hje,
me tina, vash, u do t' ndërronj kuror.

2003

IL PANNINO STESO

**Passando per la siepe vidi un panno steso. / Mi avvicinai e sentii un profumo: / era un
fazzoletto giallo oro ormai asciutto. / Dissi: "Ora sì che il destino mi protegge!". / *Partii di là,
girai di porta in porta / per trovare te, ragazza graziosa. / Ti portai il fazzoletto dimenticato, / col
tuo profumo che tanto mi piacque. / *Ora che ho scoperto dove stai / vengo a cantarti un nuovo
stornello, / ti offro un mazzo di fiori e, se ne ho l'onore, / con te, ragazza, io voglio sposarmi.*

VJERSHE PËR TË SHAJTUR

1. Çitu e mos fjit më, ti shtrëmbaloke,
se jan të rreme gjith ata që thua.
Ti je si kukuvela që k'ndon naten
e trëmben gjith njeri që mbë gjum u shtruan.
2. Ti vete arrukullima si llonxhele,
u vinj aprisu tue mbjedhur lile
e mbjova t' tër një thes e thaç: Kanala,
se nderen tënde ti vete tue e shkelur.
3. E vete lart e posht si kacidhjare,
nëng dimi nderen tënde ku e vure.
Thueje nd'e shtore o edhe nd'e bore
e ng' dikuron se je e qëndron pa fare.

2002

STORNELLI DI SDEGNO

*1. Zitta, bugiarda, non aprire bocca, / ché altro non sai fare che mentire. / Tu sei civetta dal
notturno canto / che spaventa la gente addormentata. / 2. Vai rotolando giù come un orciuolo /
ed io ti seguo raccogliendo i cocci. / Un sacco ne riempi. Dissi: "Mannaggia, / metter così
l'onore sotto i piedi!". / 3. Tu vai su e giù come un saltimbanco, / non sappiamo dove hai messo
l'onore. / Di' se l'hai gettato oppure perso / e spensieratamente ne resti senza.*

TUE SHURBIER ME KOZM RROKUN

Ish e treta e marr çë m' kish llonari
e Kozmi ish e mbjidhej ka Mulliri.
Tri cika mala më ngrakoi ghadhurin
e ai vini llishu llishu fanmiri.

U mb'udh i dolla e mb'ëmer e sërrita
e nd'at momend u gjegj çë bij mjezdita.
U prur ka u e "Gje!" më rrispëndoi
e u i thaç mbashaten se t'e dij.

Ai m'u nis me rrasp e me martjele
e sulli edhe skarpjele e sqapar.
M'u dish edhe zbcocin e strungatur
e se t' dollarjim mbjatu atë dru.

U vum çë tra dhesper e mjezdit
çë për ca njeris ë më se mjeznat.
E nxurtim shkarda e nxurtim dhe buhua
njera çë druri mëngen u buthtua.

2002

AL LAVORO CON COSMO ROCCO

Era il terzo martedì di luglio / e Cosmo ritornava da Mulino. / Di poche frasche aveva caricato
l'asino / e lietamente se ne veniva bel bello. / * Gli andai incontro e lo chiamai per nome / e in
quel momento si sentì che suonava mezzogiorno. / Si volse verso di me e "Dimmi" mi rispose / e
io lo misi al corrente della faccenda. / * Egli si avvìò con raspa e martelli / e portò anche scalpelli
e ascia. / Furono necessari anche la pialletta e la sega / per lisciare in breve tempo quel legno. /
* Ci mettemmo al lavoro nel primo pomeriggio, / ora che per alcuni è peggio di mezzanotte. /
Togliemmo schegge e togliemmo tanta segatura / fino a che il legno non prese forma di mangano.

GUSHTI STRIGAJOT

Sa e mira ë kjo dita sot,
gëzon katundi strigajot.
Kado ruen, kado shkon
me hare zëmren e mbjon..
Mbjidhen bilt e Strigarit
ka Europa, ka Merka, ka Bonsajri.

Vinjen e çonjen ajrin e par,
shpizen ku u len, udhen ku ngan
edhe kërkonjen miqërin çë lrien
me dishërimin e madh çë ndë zëmer sjellen.
Kta jan bilt ton çë vinjen mbë shpi
me nder e me mall, me fjalën e mir.

Na ç'rromi ktu i bëmi ghadhi,
i duemi me ne, i mbami mbë shpi
e ditat shkonjen me lleshri,
me joqe, me valla, me aq bukuri.
Ma moti shkurtohet, gushti fërrnon,
bilt e Strigarit lërenjen kto shpi.

E thon:
Na kem vemi, shurbemja na pret,
ma nd' daft Inzot na shihemi mot.

E ven...
me helme ndë zëmer, me sit mbë lot.

2004

L'AGOSTO SANCOSMITANO

*Che bello questo giorno, / gioisce il paese di S. Cosmo. / Per dove guardi e passi / riempi di gioia il
cuore. / Ritornano i figli di Strigari / dall'Europa e dalle Americhe. / *Vengono a ritrovare l'aria
natia, / la casa di nascita, le note strade / e cercano gli amici lasciati / col forte desiderio che hanno in
cuore. / Sono i nostri figli che tornano a casa / con onore e affetto, con la parola assennata. / *Noi che
viviamo qui facciamo loro festa, / li vogliamo con noi, li ospitiamo / e i giorni passano allegramente /
tra giochi, balli e tante cose belle. / Ma il tempo è agli sgoccioli, agosto finisce, / i figli di Strigari
lasciano le nostre case. / *E dicono: / È tempo di partire, il lavoro ci attende, / se Dio vorrà, ci
vedremo fra un anno. / *E vanno... / col cuore in pena, con gli occhi in pianto.

SHËN PIU

Te kjo dit aq e gëzuer
na u nistim me dhivucjon.
Vem' e çomi Shën Piun e bekuer
çë shum mir e dish Inzot.

Na i përgjunjëmi e i thomi nj' racjon:
"O Shënjt fanmir, parkales për ne.
Mos harrò bilt ton
çë të shprisht jan për ndë dhe".

Shënjt i mir çë ka qielli na ruen,
bëna një ghraxje e mos na mëno,
ndëlena mb'katët çë kemi ngrakuer,
ëna gëzimin çë na mangon.

Me ghraxjen tënde na vemi ndë shhpi,
paqen e shpirtit e qellmi me ne,
na të kultomi e të bëmi hadhi
se ghllorja jote sallvoft kët dhe.

Me kët sperënx lëremi kët shesh.
Jemi bilt tënd, na jemi arbëresh.

Agosto 2003

SAN PIO

**In questo lieto giorno / siamo partiti devotamente / per visitare S. Pio / tanto amato dal Signore. / *Preghiamo inginocchiati / "O Santo felice, prega per noi. / Non dimenticare i tuoi figli / sparsi per tutto il mondo". / * Santo benevolo che dal cielo ci proteggi, / facci una grazia e non tardare, / perdonaci i peccati che ci gravano, / dacci la gioia che ci manca. / *Ce ne torniamo a casa con la tua grazia, / portando con noi la pace dell'anima, / noi ti ricordiamo e festeggiamo, / salvi la tua gloria questo mondo. / *Con questa speranza lasciamo il piazzale, / siamo tuoi figli, noi siamo albanesi.*

DJAL BULAR

Ti je si një gharofull nd' paraver
i bukur edhe si nj' ëngjell ç'ecen dhen.
Belicen tënde ka do vete qell
e vashët të kërkonjen për namuri.

Arduri it ndihet si një djal bular.
Kërko ti lulen, kërko vashen e mir,
përzije zëmren me një rregjëresh
e trimrìn me të shtrëngo mbë mes.

Te nj' ghrast qandoni kto di lule,
një gharofull e një trendofile...

14.2.2006

NOBILE GIOVANE

*Aer gentil di maggio
che al fior scote il profumo,
come ad un giovin paggio
che il cuor mette in comune
e fa che di due steli...
si fonda un fiore sol.*

Traduzione dell'autore. La poesia è dedicata al dott. Salvatore Mondera.

DIMRI

Dimri erdh e mali u mbulua me bor,
arvuri pa fjet kurmin prën.
Dielli butthohet pak e rri mbi re,
fthohet era, njeriu duron më shumë.

Kulton ditën e mir ndë paraver
kur ngrohen dielli e kur gdhodhiren hjen.
Kështu qe bën ki dhe e mosnjeri
s' mund ndërronj jeten si të vë**.

2004

L'INVERNO

**L'inverno è arrivato, s'è coperta di neve la montagna, / l'albero spoglio riposa. / Poco si vede il sole, nascosto dalle nubi, / l'aria è fredda e si soffre di più. / *Tu ricordi il bel giorno di primavera / quando il sole scalda e ti godi l'ombra. / Ma così è fatto il mondo e nessuno / può cambiare il corso delle cose.*

**Antica forma di congiuntivo, presente anche nel De Rada.

KËNKA SHPIS TË NIKOLLELES

I bukuri Strigar, i bëgat e shumë i mir,
ktu fjetet për një masar
çë ndë shpi kish vet një bir.
In të mir e ndë të par,
ma s'patin shumë fërtun.
Qen shumë mot të cingarjatur,
një cik të zën, një cik të ndajtur.

Ati rronej ndo një shpi
me çirep e me kusi,
mbanej një linar vali
e një zjarr ç'rrij sembre çelur.
Digj të holla e lis të tër
e vore i bënei çer.
Rronei si ja thoj fati
sa vet'hen Inzot ja ngjati.

Kish një shpi të vjetërue,
si fishele i vejën muret.
Sembre thoj se kur vdes u
kush qëndron e çon kështu.
Biri thoj tue ju truejtur
"Tat, e ndreqmi kët shpi?".
Ati thoj: "Jo, të sholartur,
si thom u, kështu ka t' rri".

LA POESIA DELLA CASA DI NICOLELLA (Giuseppe Busa)

**S. Cosmo bello, ricco e tanto buono, / qui si parla di un massaiolo / che a casa aveva un unico figlio. / Erano brava gente e ben in vista / ma un tantino sfortunati, / a lungo in lite, / per un po' in rotta, per un po' separati. / *Il padre abitava in una casa / dotata di caminetto e paiolo, / aveva una lucerna ad olio / e un fuoco sempre acceso. / Bruciava frasche e querce intere / e sfidava la tramontana. / Viveva secondo il volere del destino / per quanto Dio lo tenne in vita. / *Aveva una casa antica / coi muri sgangherati / e ripeteva: "Alla mia morte / così devono trovarla gli eredi". / Diceva il figlio implorandolo: / "Papà, aggiustiamo la casa!", / ma il padre ribatteva: "No, deve restare / diroccata com'è adesso". /*

Suçëdhirti pra nje dit
se tue thën "Oj tat, oj tat,
ëm kunxil te kjo mbashat!
Nga, se bëra një penxat!",
biri thoj: "U luenj një pal
se t'i shkulin të paren fjal".
Diti mir si t'e zëj
e mbë llac bën e qëndroi.

Pjaku ... u pendir tek ajo fjal,
iku e vate Marrakol,
ndënj një jav edhe më gjë
fjēj ndë tropa si një lir.
Ma sa moti tramutoi
lidhi k'puct e zu e shërtoi,
lëreu kopsht edhe akuar
e ndë katund m'u rriçetar.

Ata dit ç'ai nëng ish
vum gjith lëkur e mish,
xheshtim mure e zhgangullata,
shtum kaçë e matunata.
Nxuertim trav' e qeramidhe,
çiminere edhe tijile,
stjerr nxuertim e buhua,
shtum djers krua krua.

*Avvenne poi un giorno / che dicendo "Papà, papà, / dammi consiglio in questo frangente, / su,
mi è venuta un'idea" / diceva il figlio: "Faccio un tentativo di strappargli il consenso". /
Abilmente con le buone / lo prese in trappola. / *Tardi il vecchio si pentì / e si ritirò a Marracolle,
/ ci stette più di una settimana / dormendo nel bosco come un ghio. / Ma come cambiò il tempo
/ si legò le scarpe sospirando, / abbandonò orto e acquaio / e di nuovo si rifugiò in paese. / *Nei
giorni in cui era assente / ce la mettemmo tutta: / stonacammo i muri, / gettammo giù i solai, /
abbattemmo le acacie, staccammo il pavimento, / togliemmo travi e tegole, / canne fumarie e
traversine, / togliemmo via zavorra e polvere, / sudando a più non posso. /

E pra pjaku nga menat
vej te konza penxjonat.
Me kumba Vishilin thoj
se llu shkashu nëng e doj.
Pra kur vej kumba Paskalli:
"Nga, se mua m'muri malli!".
Mbjatu zëmra i lleghrarej
e te Belluçi më kallarej.

Kumba Kozmi nga menat
kish t'e bënej një façat:
her na kronaka na thoj,
her sa mot angò na zëj.
Thoj së gjegjëni ka qaca
shum fjal e murmurata:
"E sa duhet t'japen fin?
Ç'ë kastjel o ç'ë kazin?".

Ndrikulla Krexe, uzi saj,
nga cik një shurbes na thoj.
Doj limishte e cika mala,
edhe dhia kish t'ish e mjela.
E thoj: "Karmen shallakun,
ti ke t' bëheç me purtun.
Ti çë na bëre aq hadhi
na nderon kët gjitoni".

*Ogni mattina il vecchio / andava come un pensionato alla nicchia. / Diceva a compare Visciglia
/ che quello scasso non gli andava giù. / Poi quando arrivava compare Pasquale: / "Vieni, ché
m'ha preso il desiderio". / Subito gli si rallegrava il cuore / e scendeva da Bellucci il cantiniere. /
*Compare Cosmo ogni mattina / andava a fare la visitina: / ora raccontava qualche fatto, / ora
quanto tempo avrebbe richiesto l'opera. / Riferiva che in piazza si sentivano / parole di critica: /
"Quanto ci vuole per finire? / E' un castello o un casale?". / *Comare Lucrezia, secondo il suo
solito, / aveva sempre qualcosa da dire. / Voleva trucioli e resti di legname / e pretendeva che le
mungessimo la capra. / Diceva: "Carmine scialacquatore, / ti si addice una casa col portone. /
Con la tua magnificenza / onori il vicinato". /

Dhon Xhuani nga menat
kish t'e bëj nj' predhikat.
Dil te lloxha e zëj kangjelin
e me dor mbanei butilen.
Her me Pllutin e me Dandin,
her e zëj me Fioravandin.
Ma kur Krexja i jip lla spinda,
zëj e këndoj lla Mariollinda.

Ish ai Frangjiskandon
çë fishkarnej e këndoni,
kur façonej te lloxheta
thoj se qielli kish xhapeta.
Me qanocull e sqapar
rripararnej ata der
e thoj: "Kam shurbenj me priz
se u jam si i shpis".

Dhe Xhervazi me at ghadhur
sill ka Ghrutza ata shur.
Kur pra vej ka Sanda Roza,
e doj ngrëjtur n'atra koza.
Vej e vini shum karrera
se të ndodhej mir te hera.
Pes vjaxhe ç'ish jurnata,
her i zëj puru mjeznata.

**Don Giovanni (Serembe, il marito), ogni mattina / doveva strologare. / Usciva sulla loggia e cominciava la cantilena / tenendo in mano la bottiglia. / A volte Pluto, a volte Dante, / a volte citava Fioravante. / Ma quando Lucrezia gli dava corda / attaccava la Mariolita. / *C'era Francescantonio / che fischiava e cantava. / Quando si affacciava alla loggia / diceva che il cielo era nuvoloso. / Con la piella e l'ascia / riparava le porte / dicendo: "Devo lavorare di buona lena / perché faccio parte del parentado". / *Gervasio con l'asino / trasportava sabbia dalla Grotta. / Ma se andava a S. Rosa / pretendeva qualcosa in più. / Andava e tornava con rapidità / per trovarsi in orario. / Per i suoi cinque viaggi giornalieri / a volte arrivava a mezzanotte. /*

Fallinjam e muratur,
kapodhart ai Mastru Tur.
Bëri shkalla edhe stalata,
vu retina e matunata.
Me at pip tue ngrakuer,
me at gozhd tue çivuer.
Shkojin jav e shkojin dit
me at meter mat e mat.

Na zum e vum dor
tue kërkur vër për vër.
Nga shkallash m'u rriparar,
i dreqtuer erdh nga mur,
nga trav m'u situar,
arkitrav m'u vu nga der...
E pra pjaku zu e tha:
"Mo vi va, mo vi va!".

Ndandu vatra e çiminer,
furnaxhele edhe maghare,
bëm kullona çë jan si mure,
vum rriqine ndë kavalare,
bëm kornixha me matune,
mbjum me borde ata spikune.
Pjot me busolla e me dera,
jan purtune edhe me sfera.

**Falegname e muratore, / eccellente capomastro era Tore. / Fece scale e tramezzi, / posò reti metalliche e pavimenti / sempre caricando la pipa / e scavandola con un chiodo. / Per settimane e giorni / sempre misurava col suo metro. / *Ci mettemmo all'opera / frugando in ogni buco. / Ogni scasso fu riparato, / ogni muro venne raddrizzato, / ogni trave collocata al suo posto, / ad ogni porta fu posto l'architrave. / E il vecchio prese a dire: / "E' il vostro momento, questo!". / *Intanto costruiamo focolari e canne fumarie, / fornelli e bocche del camino, / colonne poderose come muri, / mettemmo cunei nelle travi maestre, / facemmo cornici di mattoni, / riempimmo di bordi gli angoli. / Tante porte e porticine / e anche portoni con l'arco di ferro. /*

Nani që na shkoi paghura,
le të vinj draghunara.
Qeramidhe e kanalleta
frishkullonjen si sajeta.
Bëm furre e bën koçele,
hami dhi e hami dele.
Kjo ë shpi me shum spas,
ng'ë kalive, ma pëllas.

E gjegjn'je e mirrn'je vesh, gjith gjitonia,
se zum kur ish sulliuni e fërrnuem me bor.

1948

**Ora che siamo al sicuro, / venga pure la tempesta. / Tegole e canali di gronda / sprizzano l'acqua. / Abbiamo fatto forni e fornacelle, / mangiamo capre e pecore. / E' una casa spaziosa, / non è una capanna, è un palazzo. / *Voi tutti, vicini, ascoltate e capite: / cominciammo col solleone e terminammo con la neve.*

NJË KART PËR ATEJA

T' shkrunj tia, mëm, se t' thom
se të penxonj nga dita
e s'mund harronj t' miret që më dhe.
Ti mos rri e pisëruer
për mua se qëndrova vet
se pse ti vet së m' l'reve.

Ti ike, se mortja është e ktij dheu,
ma mua së m' l'reve vet, mëm.
Ti m' l'reve ardurin tënd
që ka do vete e ndienj,
ti m' leve hjen tënde
që ka do vete e çonj përpara.
U ka do shkonj shoh pedhaten tënde
që m' qell ka udha mir.

U së qëndrova vet, oj mëm,
kam të ndiret tënd që m' dhe,
kam sit tënd e fuqin tënde që m' lëreve.
Mëm, mëma ime,
vet të shkruajturit mund të dërgonj,
se fjala s' rrëvon te ti.

Doj të shkruenja me nj' pend e art
kët fjal e bukur
edhe vuxhen time
të dërgonja për ateja.

UNA LETTERA PER L'ALDILÀ

**Ti scrivo, mamma, per dirti / che ogni giorno ti penso / e non posso scordare il bene che m'hai dato. / Non startene afflitta / per me, rimasto solo, / ché solo non m'hai lasciato tu. / *Andasti via, ché alla morte non si sfugge, / ma solo non m'hai lasciato, mamma. / M'hai lasciato il tuo profumo / che sento dappertutto, / l'ombra tua m'hai lasciato / che dappertutto vedo avanti a me. / *Mamma, non sono solo: / ho il sentimento che m'hai dato, / i tuoi occhi e la forza che m'hai lasciato. / Mamma, mamma mia, soltanto / uno scritto posso mandarti, / ché a te la mia parola non arriva. / *Con una penna d'oro vorrei scriverti / questa parola bella e nell'aldilà / mandarti anche la voce. /*

Ti ike keq njëhere te ki dhe
e së më leve motin të t' kultonja
gjith të miret tënd që pata.

U jam e rronj angora e
s' di për sa mot Krishti më lë mbë vet'he
ma ditet që qëndronjen së m'e rrënjën
të t' kultonj të miret tënd.

Kultonj kur ndienja fjalën tënde
e nd'ato jet gjumi më prënej.
Ma u sperënxet ng' i bora,
se pjakëria m'u qas
e udhen të vinj te ti dhe u e çonj.

Doja t'isha djali si një her
kur ndëndnja sit tek faqja jote.
Kur zënja sisen e saxjarça
e te sit tënd si pasi qir ruhça
e sa i bukur dukça!
Sa her ti m'nise, më qelle dora dora,
sa her ti më tagjise,
sa her mbë gji më solle!
Me amurin tënd u rrita,
te moti u gëllita.
Sa her ti më porsite
e trim bën e u çova!
Sa her ti më pastrove!

**Troppo presto te ne sei andata / e non m'hai lasciato il tempo per ricordare / tutto il bene ricevuto. / *Io vivo ancora / e non non so per quanto tempo Dio mi lascerà, / ma i giorni residui non mi bastano / per ricordare il tuo bene. / *Ricordo quando ascoltavo la tua parola / e fra le tue braccia mi ristorava il sonno. / Ma non ho perso le speranze, / ché la vecchiaia è vicina / e troverò la strada per venire da te. / *Vorrei essere fanciullo come un tempo / quando nel tuo volto saziavo i miei occhi, / quando mi attaccavo al seno e mi satollavo / e come in uno specchio mi guardavo nei tuoi occhi / e mi vedevo bello. / Quante volte m'hai avviato, m'hai portato per mano, / quante volte m'hai imboccato, / m'hai portato in braccio. / Sono cresciuto col tuo amore, / col tempo sono venuto su. / Quanti consigli m'hai dato / e m'hai fatto ritrovare giovane. / Quante volte m'hai pulito! /*

Më qelle edhe mbë qish tek Inzot
e pakëzimin ti dhe bin e mora
e ti tue parkalesur mbë shpi mbë gji më solle.
Dit për dit më rrite
me mall e me harë
e zëmra jote pjasënej për mua
e thoj: "Sa mir të dua!".
Kur te gjumi më vënje, te djepi naka naka
me zanin tënd ti thonje racjonen e t'Inzot:
"Kuçë nina, bir, kuçë nina, mall,
te zëmra ime shtrohu, ti illi im i par".

2005

**M'hai portato anche in chiesa dal Signore, / mi hai fatto battezzare / e, pregando, in braccio m'hai riportato a casa. / Giorno per giorno m'hai cresciuto / con amore, con gioia / e per me s'agitava il tuo cuore, / e diceva: "Quanto bene ti voglio!". / Quando mi mettevi a dormire nella culla / con la tua voce recitavi la preghiera di Gesù Bambino: / "Dormi, figlio, dormi, amore, / stenditi sul mio cuore tu, la mia prima stella".*